



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE

UDHEZIM

Nr. 04, date 28.09.2012

“Mbi trajtimin e produkteve me akcize te paraqeguar, por qe hidhen per konsum pas dates
30.09.2012”

Me qellim zbatimin e Ligjit nr.61/2012 “Per Akcizat ne republiken e eShqiperise”, ne mbeshtethe te nenit 17 te ketij ligji, lidhur me kushtet e pageses dhe nivelin e detyrimit te Akcizes, Drejtori i pergjithshem i Doganave:

UDHEZON

Produktet qe i nenshkrohen akcizes, te cilat e kane parapaguar detyrimin per akcizen ne momentin e porositjes se pullave, do te taksohen sipas kushteve dhe nivelit ne fuqi ne momentin e hedhjes per konsum te ketyre produkteve.

Per kete :

Subjekti importues paraqet ne departamentin e Akcizes, prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, dokumentacionin vertetues te pagese se pullave per produktet e akcizes qe po importon.

Departamenti i akcizes, verifikon vertetesine e informacionit te paraqitur nga subjekti nepermjet kontrollit te bilancit te pullave te parapaguara dhe atyre te importuara si dhe percakton numrin, llojin dhe vleren e sakte te pullave me akcize te parapaguar dhe atyre te importuara si dhe percakton numrin, llojin e vleren e sakte te pullave me akcize te parapaguar, port e pa importuar ende.

Nqs pas kryerjes se bilancit te mesiperm rezulton se nje pjese ose e gjithe sasia e produkteve qe po importohen jane me akcize te paraqeguar, atehere Departamenti i Akcizes, nepermjet aktivizimit te kodeve shtese :

Kategoria (sipas shtojces 1 te Ligjit te Akcizes 61/2012)	Kodi shtese qe duhet te vendoset ne kutine 37b
B000 Birra	B0P
W200 Vere e eqete dhe pijet e qeta te fermentuara	W2P
W300 Vera spumante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe te gazuara	W3P

I000 Pije alkoolike te ndermjetme	10P
S200 Pije alkoolike (Spirituous Beverages)	S2P
T200 Cigare qe permbajne duhan	T2P
T300 Puro dhe cigarillos	T3P
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zevendesues duhani	T5P

-Per NIPT-in e subjektit perkates ne sistemin “Informatik te Doganes”, lejon importimin pa detyrime akcize per sasine e produkteve me akcize te parapaguar. Kodet shtese happen ne system rast pas rasti per cdo subject dhe per cdo import te vecante qe ka nje subject dhe per cdo import te vecante qe nje subject do te kryeje pas plotesimit te kushtit te mesiperm.

d. Per secilin nga subjektet qe i nenshtrohen kesaj procedure, Departamenti i Akcizes, mban evidence te perpikte deri ne hedhjen per konsum te sasise se plote te produkteve me akcize te parapaguar (sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi).

e. Nqs vlere e parapaguar ezaurohet para importimit te plote te produkteve me pullen e parapaguar, cka nenkupton se detyrimet e akcizes sipas niveleve sipas niveleve te taksimit me ligjin 61/2012 jane me te larta se ato te parapaguara, atehere sasia e mbetur do te hidhet ne konsum duke paguar detyrimin e akcizes sipas ligjit ne fuqi.

f. Nqs detyrimet e akcizes te llogaritura sipas niveleve te taksimit me ligjin 61/2012, jane me te ulta se ato te parapaguara, atehere produkti do te hidhet per konsum me akcize te perjashtuar dhe administrate doganore nuk ben asnje veprim financiar perjashtues.

g. Nqs ne ngarkesen e fundit, vlere e parapaguar mbulon detyrimin e llogaritur sipas nivelit te taksimit ne fuqi vetem per nje pjese te produkti qe ndodhet ne te, atehere do te perpilohen dy deklarata doganore/DSHA, ku e para do te jete per hedhjen ne konsum te pjeses se produktit me akcize te perjashtuar per efekt te parapagimit dhe deklarata e /DSHA e dyte per pjesen eproduktit te mbetur te pambuluar me nga parapagimi.

3. Ky udhezim hyn ne fuqi me 01.10.2012

Flamur GJYMIASHKA

DREJTOR I PERGJITHSHEM